



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 42, datë 26.02.2018**

**PËR**  
**MBYLLJEN E PORTALIT ESIG.AL**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 14 dhe 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 199, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I   S E:**

Autoriteti është vënë në dijeni se është hapur një portal me emrin esig.al, portal i cili administrohet nga shtetasi Eglent Bici, i cili është licencuar nga Autoriteti si agjent i shoqërisë “Insig” sh.a. me nr. licence 940, datë 20.10.2017. Ky informacion paraprakisht u sigurua nga investigimi që bëri Autoriteti.

Për këtë qëllim, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në datën 09.02.2018, organizoi një takim pranë zyrave të AMF-së, nëpërmjet të cilit z. Eglent Bici, pranoi se portali administrohej nga vetë z. Bici.

Autoriteti pasi analizoi rastin në fjalë, konstaton se veprimtaria e z. Bici nëpërmjet këtij portali, është veprimtari brokerimi, e cila është në kundërshtim me nenin 202 e vijues të Ligjit nr.52, datë 22.04.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, në të cilin parashikohet se: *“veprimtaria e brokerimit kryhet nga brokeri në sigurime, person juridik, të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”*.

Gjithashtu, personat e palicencuar, sipas dispozitave të këtij ligji nuk mund të përdorin emrin sigurim ose risigurim, si dhe derivatë të tij. Përdorimi në këtë rast i emrit esig, përbën shkelje dhe është objekt i sanksioneve të parashikuara në pikën 4 të nenit 251, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Nisur nga sa më sipër, Autoriteti i është drejtuar z. Bici edhe me shkresën nr. 612 prot., datë 14.02.2018, duke kërkuar mbylljen menjëherë të këtij portali.

Z. Eglent Bici, ka depozituar shkresë më datë 16.02.2018, ku informon se portali esig.al, nuk ka pasur për objekt brokerimin dhe nuk ka për qëllim përfitimin nga shitja e produkteve, por ka vetëm qëllim informues dhe ndërgjegjësues për konsumatorin, aktorët e tregut, çmimet e tregut, produktet etj. Po kështu z. Bici nëpërmjet kësaj shkrese bën me dije se ka hequr dorë plotësisht nga pronësia e këtij portali (esig.al) duke ja shitur këtë web një personi të tretë të interesuar.

Përsa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

#### **V E N D O S I:**

1. Në bazë të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me qëllim parandalimin dhe ndërprerjen e veprimeve që përbëjnë shkelje të ligjit, të kërkohet ç’regjistrimi i portalit esig.al.
2. Për zbatimin e pikës 1, më sipër, të depozitohet kërkesa pranë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**